



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT- OST SH.A.
Drejtoria Ekonomike

Nr. 6879 Prot

Tiranë, më 04/10/2018

Lënda: Kërkesë për aplikim për Tarifat e Transmetimit të Energjisë Elektrike për vitin 2019.

ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
Adresa: Blvd. Bajram Curri, Rr. Viktor Eftemiu 1023

I nderuar Z. Ahmeti,

Në përputhje me (i) Ligjin nr. 43/2015 dt. 30.4.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", (ii) Metodologjinë e Llogaritjes së tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike, OST ka përgatitur "Përlogaritjen e Tarifës për vitin kalendarik 2019".

Jeni të lutur që të merrni në shqyrtim dhe të konsideroni materialin tonë për aplikimin e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për OST për vitin 2019.

Në mbështetje të kësaj kërkesë, bashkëlidhur do të gjeni:

- Relacioni sqarues për llogaritjen e tarifës
- Dokumentat plotësuese të informacioneve të përmendura në relacion.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, jemi në dispozicionin Tuaj për çdo sqarim dhe informacion të nevojshëm.

Me respekt,

Administratori i OST sh.a.
Klodian Gradeci





RELACION

PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE TË TRANSMETIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2019

Përmbajtja

I.	Informacion i përgjithshëm rreth OST	3
II.	Niveli i synuar i të ardhurave që kërkohen prej tarifës së transmetimit	3
III.	Pritshmëria e situatës energjitike për vitin 2018	4
IV.	Parashikimi i kërkesës për vitin 2019 dhe mënyra e mbulimit të saj	6
V.	Operatori i Tregut	8
VI.	Tregu i energjisë balancuese dhe humbjeve në rrjet	9
VII.	Llogaritja e tarifave të transmetimit për vitin 2019	11
	i. Kostot kapitale	11
	ii. Kostot operuese.....	23
	iii. të ardhurat nga Alokimi i Kapaciteteve	25
VIII.	Ndarja e kostove në kapacitet dhe energji	25
	i. Pagesat e kapacitetit	25
	ii. Pagesat e energjisë.....	28
	iii. Llogaritja e tarifës mesatare të transmetimit.....	28
IX.	Metodologjia e llogaritjes së tarifës së energjisë elektrike të transmetuar.	32



I. Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri drejtohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh. a.), një kompani publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit e krijuar në 14/07/2004.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh. a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) është një nga pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri. Bazuar në këtë rol të rëndësishëm, kompania e mbështet zhvillimin e vet në planet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike në vend.

Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”.

II. Niveli i synuar i të ardhurave që kërkohen prej tarifës së transmetimit.


Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike synon të mbledhë të ardhurat e nevojshme për të zhvilluar investimet e nevojshme në sistem, për të mbuluar kostot operative të drejtimit të shoqërisë si dhe për të minimizuar humbjet në rrjetin e transmetimit.

Tarifa e transmetimit synon të shlyejë kostot e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Pronësinë, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave, kablllove, nënstacioneve, transformatoreve, qendrave dispeçer dhe ndërtesave që lidhen me to si dhe facilitetet e komunikimit.
- b) Kostot e rezervave operuese të OST-së që nevojiten për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit të transmetimit.
- c) Kostot e shërbimeve të tjera ndihmëse të OST-së, përfshirë pagesat e bëra OST-ve fqinje për të siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva të çastit dhe pagesat (nëse ka) për frekuencën dhe rregullimin e tensionit.
- d) Kostot e kompensimit të energjisë reaktive, që duhen alokuar në një pagesë për energjinë reaktive.
- e) Kostot për të siguruar zyra, komunikim dhe facilitete të Teknologjisë së Informacionit (IT) për Operatorin e Tregut plus kostot e personelit që lidhen me Operatorin e Tregut. Nga këndvështrimi kontabël Operatori i Tregut duhet të këtë llogaritë e tij, sikur të ishte një njësi ligjore e pavarur me të ardhura të tatueshme më vete.

III. Pritshmëria e situatës energjitike për vitin 2018

Përshkrimi (GWh)	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Pritshmëria 2018
ENERGJIA TOTALE QË HYJN NË SISTEM	6416	6997	8472	7430	7679	9035	7699	7830	8250	7,577	10,100
- Prodhim vendës	3,788	5,032	7,467	3,956	4,449	6,712	4,343	5,475	6,000	4,174	8,058
- Energji në marrje	2,628	1,964	1,005	3,474	3,230	2,323	3,356	2,355	2,250	3,403	2,044
ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR	6163	6785	8215	7257	7509	8825	7538	7672	8080	7,418	9,852
- Energji e dhënë	163	536	1,736	293	336	1,425	288	958	1500	488	2771
- Energji e transmetuar për OSHEE	5,758	6,213	6,284	6,832	6,576	6,797	6,553	6,106	5,980	6,149	6114
- Energji e transmetuar për Klientët e Kualifikuar	242	36	194	131	597	603	697	610	600	781	967
Humbjet në rrjetin e Transmetimit → Nevojat Vetiake	253	211	257	173	169	210	161	159	170	159	248
Humbjet në rrjetin e Transmetimit në %	3.02	3.02	3.03	2.33	2.21	2.32	2.09	2.03	2.06	2.10	2.45%



Shënim: të dhënat janë shprehur në GWh



Realizimi i parametrave kryesorë energjetikë gjatë vitit 2018

Viti 2018 filloi me një kuotë rreth 290 metra në liqenin e Fierzës, një kuotë afër nivelit maksimal të lejuar dhe mjaft të favorshme për ruajtjen e një niveli normal të sigurisë së furnizimit. Prurjet mesatare mujore të lumit Drin në liqenin e Fierzës, për gjashtë mujorin e parë të vitit ishin dy deri në tre herë më të mëdha se prurjet llogaritëse me 75% siguri. Si rrjedhojë e kësaj, u rrit ndjeshëm gjenerimi i vendit si nga ana e KESH ashtu edhe nga të gjitha PPE-të, duke bërë që importi i planifikuar nga ana e OSHEE të reduktohet afër zeros (me përjashtim të kontratës me bazë vjetore), dhe nga ana tjetër është kaluar në eksportin e energjisë duke realizuar sasi të konsiderueshme, gjë e cila u shoqërua me rritjen e ndjeshme të humbjeve në rrjetin e transmetimit.

Bazuar në të dhënat e deritanishme dhe në parashikimin për muajt e ardhshëm, pritet që gjenerimi i vendit të jetë rreth 8 TWh, humbjet në rrjetin e transmetimit rreth 248 GWh dhe konsumi i vendit rreth 7 TWh. Pjesa e mbetur e energjisë rreth 727 GWh rezulton eksport neto.


Në tabelën e mëposhtme jepen treguesit kryesorë të Prodhimit, Shkëmbimit dhe Konsumit për vitin 2018.

Viti 2018	Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Prurja ne Fierze, me 75% siguri	m3/s	148	169	177	232	195	112	58	41	50	63	110	169	127
Prurja ne Fierze, faktike	m3/s	239	428	704	454	303	168	117	100	50	65	110	170	242
Kuota ne Fierze ne fillim te muajit	m	289.9	289.5	291.0	296.3	296.6	295.9	296.2	291.9	286.5	283.2	282.0	283.0	
Kuota ne Fierze ne fund te muajit	m	289.5	291.0	296.3	296.6	295.9	296.2	291.9	286.5	283.2	282.0	283.0	283.3	
Diferenca mesatare ditore	cm	-1.3	5.4	17.3	1.1	-2.4	0.9	-13.9	-17.2	-11.0	-4.0	3.2	1.0	-1.7
Prodhimi ne Fierze	GWh	187.4	266.8	317.4	323.0	252.1	121.8	175.8	170.8	88.9	67.4	65.4	122.9	2160
Prodhimi ne Koman	GWh	239.7	284.0	346.1	284.5	280.8	153.6	168.4	159.6	95.3	93.6	109.6	164.1	2379
Prodhimi ne V.Dejes	GWh	129.9	142.0	175.4	158.7	146.3	75.0	79.9	82.4	51.0	51.3	62.5	90.9	1245
Prodhimi ne Ashta	GWh	32.4	34.9	34.7	38.3	34.9	19.2	19.7	14.8	9.2	9.2	11.3	16.4	275
Prodhimi i Kaskades	GWh	589.4	727.7	873.7	804.5	714.2	369.6	443.9	427.6	244.3	221.5	248.8	394.1	6059
Prodhimi ne HEC e Tjere	GWh	235.1	266.7	345.2	313.7	238.6	120.9	88.4	52.1	64.8	81.8	86.4	104.2	1998
Prodhimi ne TEC	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0
Prodhimi i vendit	GWh	824.5	994.4	1218.9	1118.2	952.8	490.6	532.2	479.7	309.1	303.3	335.2	498.3	8057
Konsumi i mujor	GWh	677.1	625.5	645.3	530.9	532.4	530.4	578.3	628.5	561.1	600.9	623.2	795.9	7330
Konsumi mesatar ditor	GWh	21.8	22.3	20.8	17.7	17.2	17.7	18.7	20.3	18.7	19.4	20.8	25.7	20.1
Importi mujor	GWh	-147	-369	-574	-587	-420	40	46	149	252	298	288	298	-728
Importi mesatar ditor	GWh	-4.8	-13.2	-18.5	-19.6	-13.6	1.3	1.5	4.8	8.4	9.6	9.6	9.6	-2.1
Diferenca nga planifikimi mujor	GWh	-90.2	33.4	60.3	-14.4	0.9	-30.8	-30.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-71
Diferenca nga planifikimi ditor	GWh	-2.9	1.2	1.9	-0.5	0.0	-1.0	-1.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-0.2
Konsumi i planifikuar, mujor	GWh	767	592	585	545	531	561	609	629	561	601	623	796	7400
Konsumi i planifikuar, ditor	GWh	24.8	21.1	18.9	18.2	17.1	18.7	19.6	20.3	18.7	19.4	20.8	25.7	20.3

IV. Parashikimi i kërkesës për vitin 2019 dhe mënyra e mbulimit të saj

Mbi bazën e të dhënave historike për dhjetë vitet e fundit, rezulton se gradienti mesatar i rritjes së kërkesës për energji elektrike, që transmetohet nëpërmjet rrjetit të transmetimit është i rendit 1.8%, sic paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Viti ↓ / muaji →	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
2007	17,826	19,592	17,969	15,708	14,541	14,517	13,383	12,734	12,680	13,830	16,180	20,338	
2008	21,099	19,836	18,216	16,955	14,795	15,024	15,571	15,773	15,007	15,402	16,820	20,399	
2009	21,481	20,969	19,660	16,082	15,241	15,242	16,186	16,937	15,754	17,015	19,911	22,124	
2010	22,869	22,842	20,658	17,863	16,451	16,376	17,119	17,743	16,498	17,579	18,940	22,480	
2011	23,779	22,978	21,055	18,313	17,452	17,112	18,159	19,056	17,784	18,408	21,356	23,440	
2012	24,358	23,940	19,626	19,506	17,487	18,138	19,581	19,895	18,449	17,861	20,088	25,252	
2013	25,170	24,999	22,871	19,289	17,938	18,928	19,673	19,731	18,267	18,790	21,346	26,372	
2014	24,686	23,420	21,833	20,182	18,152	18,023	18,657	19,991	18,502	19,512	20,195	22,104	
2015	22,173	20,912	19,248	16,710	16,558	16,893	18,766	19,010	17,174	15,677	17,955	21,512	
2016	21,616	18,688	18,121	15,897	16,016	15,722	17,443	17,847	16,270	16,458	18,600	23,104	
2017	24,259	20,737	18,514	17,819	16,817	18,341	19,251	19,889	17,269	17,901	20,088	22,340	
2018	21,841	22,339	20,833	17,696	17,175	17,678	18,655						Mesatare
Rritja2007/2008	18.4%	1.2%	1.4%	7.9%	1.7%	3.5%	16.3%	23.9%	18.3%	11.4%	4.0%	0.3%	9.0%
Rritja2008/2009	1.8%	5.7%	7.9%	-5.1%	3.0%	1.4%	3.9%	7.4%	5.0%	10.5%	18.4%	8.5%	5.7%
Rritja2009/2010	6.5%	8.9%	5.1%	11.1%	7.9%	7.4%	5.8%	4.8%	4.7%	3.3%	-4.9%	1.6%	5.2%
Rritja2010/2011	4.0%	0.6%	1.9%	2.5%	6.1%	4.5%	6.1%	7.4%	7.8%	4.7%	12.8%	4.3%	5.2%
Rritja2011/2012	2.4%	4.2%	-6.8%	6.5%	0.2%	6.0%	7.8%	4.4%	3.7%	-3.0%	-5.9%	7.7%	2.3%
Rritja2012/2013	3.3%	4.4%	16.5%	-1.1%	2.6%	4.4%	0.5%	-0.8%	-1.0%	5.2%	6.3%	4.4%	3.7%
Rritja2013/2014	-1.9%	-6.3%	-4.5%	4.6%	1.2%	-4.8%	-5.2%	1.3%	1.3%	3.8%	-5.4%	-16.2%	-2.7%
Rritja2014/2015	-10.2%	-10.7%	-11.8%	-17.2%	-8.8%	-6.3%	0.6%	-4.9%	-7.2%	-19.7%	-11.1%	-2.7%	-9.2%
Rritja2015/2016	-2.5%	-10.6%	-5.9%	-4.9%	-3.3%	-6.9%	-7.1%	-6.1%	-5.3%	5.0%	3.6%	7.4%	-3.0%
Rritja2016/2017	12.2%	11.0%	2.2%	12.1%	5.0%	16.7%	10.4%	11.4%	6.1%	8.8%	8.0%	-3.3%	8.4%
Rritja2017/2018	-10.0%	7.7%	12.5%	-0.7%	2.1%	-3.6%	-3.1%						0.7%
Mesatare	2.2%	1.5%	1.7%	1.4%	1.6%	2.0%	3.3%	4.9%	3.4%	3.0%	2.6%	1.2%	2.3%
													Trend
													1.8%





Pra duke pranuar që rritja e pritshme e volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST, të jetë e rendit 1.8%, dhe duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të cdo muaji, është bërë parashikimi i volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nëpërmjet rrjetit të transmetimit për vitin 2019, si në tabelën e mëposhtme:

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Priil	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
Mujore	GWh	709	640	596	549	549	554	603	629	568	608	621	711
Mesatare ditore	MWh	22,880	22,860	19,235	18,305	17,715	18,450	19,465	20,275	18,945	19,625	20,685	22,925
Ora ↓ / Ditët →		31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31
1	MW	640	645	560	585	560	595	625	675	600	550	575	605
2	MW	570	575	490	535	520	545	570	620	545	490	535	530
3	MW	535	540	460	510	505	525	545	590	525	475	515	480
4	MW	520	535	450	505	500	515	535	575	520	465	520	470
5	MW	530	545	460	515	505	520	540	575	520	490	525	480
6	MW	585	600	500	555	540	555	580	605	555	560	610	560
7	MW	750	775	675	675	650	650	670	700	675	725	780	755
8	MW	980	1,005	850	830	785	780	800	825	785	895	945	1,015
9	MW	1,110	1,110	960	895	850	900	900	930	870	945	995	1,130
10	MW	1,130	1,125	980	900	865	890	945	970	910	935	970	1,140
11	MW	1,120	1,110	960	895	860	900	955	970	920	900	945	1,100
12	MW	1,100	1,095	940	880	855	910	965	965	935	890	925	1,065
13	MW	1,095	1,090	940	860	855	910	970	970	930	885	915	1,055
14	MW	1,090	1,095	925	845	855	900	965	970	930	890	925	1,065
15	MW	1,100	1,095	910	825	825	860	930	945	890	895	930	1,080
16	MW	1,105	1,090	890	805	785	830	890	925	870	910	950	1,110
17	MW	1,125	1,095	880	785	775	820	880	915	845	980	1,030	1,210
18	MW	1,235	1,190	920	790	785	830	880	925	855	1,110	1,170	1,310
19	MW	1,255	1,240	980	820	805	845	890	945	875	1,140	1,180	1,305
20	MW	1,245	1,235	1,000	915	840	850	910	985	980	1,085	1,150	1,290
21	MW	1,220	1,210	1,020	985	905	910	960	1035	1,005	1,040	1,080	1,250
22	MW	1,110	1,110	980	915	865	900	960	985	905	920	970	1,145
23	MW	960	970	825	805	775	820	870	900	815	800	850	990
24	MW	770	780	680	675	650	690	730	775	685	650	695	785
Σ	MWh	22,880	22,860	19,235	18,305	17,715	18,450	19,465	20,275	18,945	19,625	20,685	22,925

Në total, pritet që konsumi bruto për vitin 2019 të jetë i rreth 7.3 TWh.

Me të njëjtën mënyrë arsyetimi, pra bazuar në të dhënat historike, dhe duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit dhe volumit të kërkesës së Konsumatorëve të Kualifikuar, si dhe sasinë e energjisë që nevojitet për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmetimit, është bërë ndarja e kërkesës së pritshme si në tabelën më poshtë:

Planifikimi i parametereve kryesore energjetike per vitin 2019														
Viti 2019		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	620	539	480	422	417	420	472	503	440	476	490	570	5,849
Konsumi per KK	GWh	73	86	101	113	117	119	117	110	115	118	116	125	1,309
Humbje + N.V.	GWh	16	15	15	14	15	15	15	16	13	14	15	16	179
Kerkesa totale	GWh	709	640	596	549	549	554	604	629	568	608	621	711	7,337

Mënyra e mbulimit të kërkesës së pritshme është bërë në bazë të eksperiencës tashmë shumë vjecare, duke konsideruar prurjet në kaskadë me 75% siguri, nivelin e liqenit në Fierzë (të pritshëm) në fillim të vitit, rritjen potenciale të numrit dhe volumit të gjenerimit të PPE-ve, eksportin e mundshëm nga ana e tyre në varësi të kushteve të tregut të brendshëm të energjisë



dhe importit të energjisë që bëhet nga ana e OSHEE dhe konsumatorëve të kualifikuar, duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit të tyre dhe kërkesën për energji, dhe duke treguar kujdes gjithashtu për optimizimin e kaskadës së Drinit, ruajtjen e kuotës në Fierzë, pra eficientë e gjenerimit, si dhe fillimin e vitit tjetër me një kuotë dhe rezervë energjetike optimale për të perballuar kërkesën për energji elektrike gjithmonë në rritje.

Nga llogaritjet, me probabilitetin e pranuar të prurjeve në kaskadën e Drinit, (prurja mesatare vjetore në Fierzë 127 m³/s, në Koman 65 m³/s, në V.Dejes 23 m³/s), rezulton se prodhimi i pritshëm i kaskadës (pjesa e KESH) është i rendit 3.3 TWh, prodhimi i PPE-ve pritët të jetë rreth 1.4 TWh, dhe i gjithë prodhimi i vendit rezulton rreth 4.7 TWh sic paraqitet në tabelë:

Planifikimi i parametrevë kryesore energjetike për vitin 2019														
Viti 2019		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Prodhimi	GWh	486	472	439	477	475	337	343	368	280	311	342	406	4,737
KESH	GWh	331	309	255	313	316	257	302	327	227	178	192	283	3,290
PPE	GWh	155	163	184	164	159	80	41	41	53	133	150	123	1,447

Planifikimi i parametrevë kryesore energjetike për vitin 2019														
Viti 2019		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Importi	GWh	223	168	157	72	74	217	261	261	287	297	279	305	2,601
OSHEE	GWh	143	93	77	0	0	137	171	171	202	212	189	210	1,605
FK→KK	GWh	80	75	80	72	74	80	90	90	85	85	90	95	996

Importi i energjisë nga OSHEE për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe nga Furnizuesit e Kualifikuar për konsumatorët respektivë, është kalkuluar në mënyrë komplementare me probabilitetin e përzgjedhur të prodhimit nga hidrocentralet e vendit. Ndryshimi i sasisë vjetore të importit që mund të diktohet nga ndryshimi i prodhimit të vendit si rrjedhojë e ndryshimeve të situatës hidrike, sic e ka treguar në mjaft raste eksperiencia e deritanishme, nuk e ndryshon planifikimin e kërkesës për energji elektrike.

V. Operatori i Tregut

Operatori i Tregut (OT), pjesë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), në strategjinë e aktivitetit të tij ka zbatimin e legjislacionit në fuqi për sektorin e energjisë elektrike në fushën e Tregut të Energjisë Elektrike (TEE). E gjithë veprimtaria e OT mbështetet në strategjinë e politikave të zhvillimit të OST.

OT është në proces të strukturimit të tij, për një funksionim sa më të mirë në plotësimin e detyrave të saj në zhvillimin e TEE, në ndjekje dhe në përputhje edhe me zhvillimet rajonale dhe direktivat e Bashkimit Europian.

OT është pjesë e strukturës së OST sh.a., në nivel Departamenti. DOT administron Regjistrin e Paleve të tregut si edhe ndjek procedurat përkatëse të regjistrimit të tyre mbështetur në Rregullat e Tregut (RrT), Kodin e Sistemit të Transmetimit (KST).



Aktualisht:

- janë të regjistruar dhe me status aktiv, në TEE rreth 31 subjekte, prej të cilëve 26 subjekte në rolin e Tregtuesit (T), 14 subjekte në rolin e Furnizuesit të Kualifikuar (FK), 14 subjekte plotësojnë kushtet për të përfituar statusin Konsumatorë të Kualifikuar (KK), 8 subjekte në rolin e prodhuesit (P), kemi OSHEE në rolin e Shpërndarjes (SH), Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU), kemi KESH sh.a. në rolin e Prodhuesit (P) dhe në rolin e Tregtuesit (T).
- janë paraqitur nga palët e tregut dhe janë administruar në regjistrin e OT gjithsej 271 kontrata të transaksioneve të energjisë elektrike (6,689,660 MWh), nga të cilat :
 - o 62 kontrata (656,026 MWh) janë kontrata ndërmjet Furnizuesve dhe Konsumatorëve të Kualifikuar (15 Konsumatorë)
 - o 76 kontrata (1,562,258 MWh) janë kontrata eksporti të energjisë elektrike
 - o 24 kontrata (206,663 MWh) janë kontrata importi të energjisë elektrike
 - o 109 kontrata (4,264,713 MWh) janë kontrata shkëmbimi ndërmjet Palëve të Tregut

Gjithashtu me ndryshimet në Ligjin 43/2015 për Sektorin e Energjisë Elektrike, do të mundësohen shtimi i klientëve të cilët e blejnë energjinë elektrike në tregun e lirë.

VI. Tregu i energjisë balancuese dhe humbjeve në rrjet

- ✓ *Prokurimi i humbjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit.*

Në bazë të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit, nëpërmjet një procedure konkurrese, jodiskriminuese dhe transparente.

Për vitin 2019, humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 179 milionë kWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, dhe bazuar në të dhënat e HUPX është konsideruar çmimi mesatar vjetor prej rreth 60 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 1,400 milion lekë.

- ✓ *Prokurimi i kapacitetit rregullues dhe atij rezerve për shërbimin e balancimit.*

- Rregullimi sekondar:

Rezerva e rregullimit sekondar është rezervë e sinkronizuar dhe aktivizohet në mënyrë automatike në rast të devijimit të frekuencës nga vlera nominale dhe/ose të balancës së shkëmbimit nga vlera e programuar. Kjo rezervë vendoset në agregatët/centralin rregullues të destinuar (të kontraktuar) për këtë qëllim. Sipas Manualit Operacional të ENTSO-E (Policy 1) dhe eksperiencës së deritanishme, rezulton se kapaciteti prej ± 35 MW është i mjaftueshëm për këtë lloj rregullimi.



Çmimi i kapacitetit rezervë është marrë 270L/MWh apo 1.96 €/MW për çdo orë. Çmimi i kapacitetit rregullues do të përcaktohet me bazë tregu, por për të bërë këtë vlerësim janë konsideruar çmimet mesatare në periudha të ndryshme të aplikuar në TSO-të e rajonit. Sic paraqitet në tabelën e mëposhtme, fondi i kërkuar për këtë lloj shërbimi është i rendit 1.2 milion Euro.

Kapaciteti	Kapaciteti (MW)	Çmimi (€/MWh/h)	Nr. Ditëve	Nr. Oreve	Vlera në €	Vlera në mln Lekë
R-	35	1.96	365	24	600,936	82.93
R+	35	1.96	365	24	600,936	82.93
Totali					1,201,872	165.86

▪ Rregullimi terciar:

Rezerva e rregullimit terciar është rezervë jo automatike që aktivizohet me kërkesë të Operatorit të Sistemit, dhe përdoret për të mbajtur në efektivitet rezervën e rregullimit sekondar kur kjo ezaurohet, dhe amortizimin në një farë mase të incidenteve të mundshme në gjenerim. Nisur nga fakti se njësia gjeneruese më e madhe në Sistemin tonë është 150 MW dhe duke marrë parasysh kapacitetin rezervë në kuadër të rregullimit sekondar, është vlerësuar që kapaciteti rezervë për këtë lloj rregullimi të jetë i rendit 100 MW.

Çmimi i kapacitetit rezervë është marrë 400L/MWh apo 2.9€/MW për çdo orë. Edhe ky çmim do të përcaktohet me bazë tregu, por për të bërë këtë vlerësim janë konsideruar çmimet mesatare në periudha të ndryshme të aplikuar në TSO-të e rajonit.

Sic paraqitet në tabelën e mëposhtme, fondi i kërkuar për këtë lloj shërbimi është i rendit 2.5 milion Euro.

Kapaciteti [MW]	Çmimi [€/MWh/h]	Nr. diteve	Nr. oreve	Vlera [€]	Vlera mln LEKË
100	2.9	365	24	2,540,400	350

▪ Ridispecimi:

Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për dispeçerimin e energjisë elektrike nga centralet prodhuese në funksion të sigurisë së punës së Sistemit dhe sigurisë së furnizimit, pa ndikuar në detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike. Për të çliruar konxhestionin në rrjet, në rastet kur shfaqet, aplikohet ridispecimi, që nënkupton uljen e gjenerimit në një pikë të caktuar të injektimit në rrjet, dhe rritjen respektive të gjenerimit në një pikë tjetër të injektimit në rrjet, ose sipas rastit vetëm uljen apo rritjen e gjenerimit në funksion të konxhestionit të krijuar. Ky ndryshim i gjenerimit, krahasuar me programin e kontraktuar që ka deklaruar pjesmarrësi përkatës në treg, duhet të kompensohet nga OST, si në rastin e uljes, ashtu edhe në rastin e rritjes së gjenerimit, për një periudhë të caktuar kohore që vlerësohet nga Operatori.



Për përmasat e Sistemit tonë është vlerësuar i mjaftueshëm kapaciteti prej 100 MW (± 50 MW). Numri i ditëve potencialisht të mundshme për aplikimin e ridispecimit është marrë 100, dhe me një kohëzgjatje të mundshme prej 6 orësh, për çdo rast ridispecimi. Çmimi i këtij lloj shërbimi është marrë i përafërt me çmimin e injektimit të energjisë nga PPE-të me koncension. Sic paraqitet në tabelën e mëposhtme, fondi i kërkuar për këtë lloj shërbimi është i rendit 3.6 milion Euro ose rreth 493 milion lekë.

Kapaciteti (MW)	Çmimi (€/MWh/h)	Nr. Diteve	Nr. Oreve	Vlera në €	Vlera në mln
100	60	100	6	3,600,000	493

VII. Llogaritja e tarifave të transmetimit për vitin 2019

Sipas metodologjisë llogaritja për të ardhurat e kërkuara bëhet në bazë vjetore. OST ka llogaritur kostot totale që ajo do të perballojë gjatë gjithë vitit 2019.

Niveli i synuar i të ardhurave që kërkohen nga OST do të mbulojë të gjitha kostot r lejuara nga Metodologjia e Transmetimit të Energjisë Elektrike respektivisht kostot e kapitalit dhe kostot operative.

Niveli i synuar i të ardhurave që do të mblidhen gjatë vitit bazë është i barabartë me:

$$C = C_{\text{kapitale}} + C_{\text{operuese}}$$

A. Kostot kapitale

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit në perputhje me parashikimet afatgjata dhe me planet e zhvillimit të sektorit elektroenergjetik në tërësi është një nga funksionet themelore të OST dhe përbën një domosdoshmëri për kryerjen e funksioneve të saj.

Gjatë viteve të fundit janë kryer një sërë studimesh të sistemit të transmetimit që kanë përcaktuar projektet kryesore të nevojshme për zhvillimin e tij. Disa nga këto projekte janë në fazë implementimi dhe të tjerë, për të cilët është siguruar financimi nga institucione financiare ndërkombëtare do të vihen në zbatim në një periudhë kohore të përcaktuar.

VII.1. Investimet me fondet e huazuara që janë në proces implementimi

VII.1.1 Projekti për instalimin e Matjes në Konsumatorët TM dhe Qendra e Menaxhimit të informacionit.

Projekti është komponenti i tretë i programit “Rimëkëmbja e Energjisë” të financuar nga Banka Botërore dhe OST.

Ky projekt përfshin vendosjen e një sistemi të ri të matjes On Line në konsumatorët e Tensionit të mesëm dhe Fidrat e Tensionit të mesëm si dhe ngritjen e qendrës së Menaxhimit të të dhënave pranë OST. Realizimi i këtij projekti do të krijojë kushtet e nevojshme për të realizuar daljen e ketyre konsumatoreve në tregun e hapur të energjisë elektrike. Sistemi i matjes do të përfshijë të gjithë fiderat dalës të tensionit të mesëm 20 kV, 10 kV dhe 6 kV nga N/stacionet e OSHEE, rreth 1167 pika matje, rreth 94 IPP dhe do të vazhdojë me klientët me të mëdhenj të lidhur në rrjetin e tensionit të mesëm, rreth 1067. Sistemi do të jetë i aftë të përpunojë të dhënat për 50,000 klientë, që do të operojnë në tregun e lirë të energjisë elektrike, me mundësi shtimi deri në 70,000 pika matjeje.


Hapja e tregut të energjisë elektrike është një nga objektivat kryesorë të qeverisë shqiptare dhe si e tillë është një prioritet për OST.

VII.2 Investimet me anë të fondeve të huazuara që pritet të implementohen


VII.2.1. Projekti Eficienca e Energjisë

Ky projekt përfshin ndërtimin e Linjës 220 kV me dy qarqe Tirana2- Rrashbull dhe fuqizimi i N/st. 220/110 kV Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës.

Projekti është financuar nga një kredi e Qeverisë Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW. Ky projekt do të bëjë të mundur rritjen e besueshmërisë së funksionimit të rrjetit 220 kV të rajonit të Durrësit dhe të Jugut të Shqipërisë duke plotësuar kriteret teknike të sigurisë dhe cilësisë. Gjithashtu ky projekt do të përmirësojnë kushtet aktuale të furnizimit me energji elektrike të qytetit të Tiranës, duke konsideruar që një pjesë e rëndësishme e rrjetit unazor 110 kV që furnizon me energji elektrike nënstationet e sistemit të shpërndarjes në zonën e Tiranës, i ndërtuar përpara mbi 40 vjetësh përbëhet nga linja ajrore të amortizuara dhe kapacitete transmetimi të limituar.



Linja 220 kV me dy qarqe Tirana2- Rrashbull dhe fuqizimi i N/st. 220/110 kV Rrashbull pjesë e Projektit Eficienca e Energjisë.



Skema njëfazore e realizimit të projektit të Unazës së Tiranës pjesë e Projektit Eficenca e Energjisë.

VII.2.2 Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV Elbasan2 (Shqiperi) – Bitola (Maqedoni) dhe Elbasan2 – Fier si dhe si dhe zgjerimi i nënstacioneve Elbasan2 dhe Fier

Projekti është financuar nga një kredi e Qeverise Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW. Ky projekt përforcon lidhjet interkonjektive me rrjetin rajonal të energjisë elektrike, duke krijuar kushte për shkembime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon, zhvillon rrjetin 400 kV në zonën Jugore të Shqipërisë ku parashikohen të zhvillohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike, dhe si pjese e infrastrukturës së Korridorit të Tetë European krijon mundësi të mira për lidhje nëpërmjet kabllit nënujor me Italinë.


Financimi i projektit të transmetimit të energjisë elektrike, i cili përbëhet nga dy pjesë: (i) Elbasan - Qafë-Thanë dhe (ii) Elbasan-Fier, do të sigurohet nga Bashkëpunimi Gjerman Shqiptar i Zhvillimit.

Qeveria Gjermane, tashmë ka angazhuar fonde për një kredi të zhvillimit deri në 50 milion Euro për Qeverinë e Shqipërisë.

Përveç kësaj, për të mbuluar financimin e plotë të projektit do të vihen në dispozicion edhe një grant investim nga WBIF deri në 14 Milion EUR.

Gjithashtu, rreth 1.2 Milion Euro, do të angazhohen nga WBIF dhe Bashkëpunimi për Zhvillim Gjermano Shqiptar, fonde të cilat do të përdoren për përgatitjen e dizajnit kryesor.

Së fundmi, OST sh.a, është angazhuar të mbulojë gjatë implementimit të projektit dhe kostot lokale, të cilat janë përlogaritur të jenë rreth 5 milion Euro.



Gjurma e linjës 400 kV të interkoneksionit Elbasan2 – Manastir




Diagrama njëfazore, linja 400 kV Elbasan – Fier

VII.2.3 Projekti për realizimin e një studimi Master Plan të zhvillimit të Sistemit të Transmetimit

Projekti është financuar nga një Grant i Qeverisë Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW. Ky projekt synon që të realizojë përgatitjen e një Master Plani Zhvillimi të Sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri.



Ky projekt synon që të realizojë përgatitjen e një Master Plani Zhvillimi të Sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Realizimi i këtij Master Plani do të shërbejë për të krijuar një zhvillim sa më të koordinuar dhe harmonik ndërmjet realizimit të investimeve me prioritet në sistemin e transmetimit. Me këtë Master-Plan, synohet të vlerësohet dhe të shqyrtohet gjendja e sistemit ekzistues të transmetimit dhe të identifikohen kufizimet aktuale të Sistemit të Transmetimit në Shqipëri dhe ato që mund të lindin në të ardhmen.

VII.3 INVESTIMET ME FONDET E OST

Përveç investimeve për projektet madhore të planifikuara për t'u mbuluar nëpërmjet kredive me institucionet financiare ndërkombëtare, OST ka planifikuar për vitin 2019 investime me fondet e veta, për rehabilitimin dhe fuqizimin e sistemit të transmetimit.

Projektet kryesore dhe me të rëndësishme të parashikuara për vitin 2018, por që do të mbulohen financiarisht përgjatë të gjithë vitit 2019, për t'u realizuara me fondet e OST sh.a. janë si më poshtë:

➤ *Lot -I- i projektit : Linja e re 220 kV Burrel – Peshkopi dhe N/st 220/110 kV Peshkopi*

Rrjeti elektrik në segmentet Fierzë – Fushë Arrëz – Kukës – Lapaj – Peshkopi – Bulqizë – Burrel përfaqëson një unazë 110 kV me një shtrirje në të gjithë zonen verilindore të vendit, në të cilin janë lidhur dhe janë miratuar për lidhje një numer i madh HEC-esh me fuqi të përgjithëshme 281MW. Ky rrjet është në pamundësi të plotë për të përcjellë një kapacitet të tillë gjenerues dhe aktualisht shkakton shumë ndërprerje tek HEC-et ekzistues dhe konsumatorët e zonës.

Me përjashtim të segmentit Lapaj – Peshkopi, i ndërtuar vitet e fundit, të gjithë linjat e kësaj unaze janë të amortizuara dhe me seksion të përcjellësve AC 120 mm² dhe AC 95 mm². Duke patur parasysh dhe kushtet e vështira të motit dhe terrenit ku ato kalojnë, ndërprerjet janë të shpeshta dhe koha e riparimit të tyre relativisht e gjatë.


Në periudhat me hidrologji të mirë kur kemi dhe gjenerim maksimal të centraleve të lidhur në këtë unazë, fluksi i fuqisë kalon nga rrjeti 110 kV në atë 220 kV nëpërmjet dy nënstacioneve 220/110 kV Burrel dhe Fierzë. në situata të tilla, për shkak të gjatësisë së madhe të rrjetit unazor edhe profili i tensionit pëson një thyerje të theksuar duke arritur në burimet gjeneruese të largëta në vlera që arrijnë kufijtë maksimal të lejuar. Në këto kushte, rikonstruksioni dhe fuqizimi i këtij rrjeti përbën një emergjence.

Zgjidhja me optimale, që do të krijonte mundësinë edhe të fuqizimit të mëtejshëm të unazes në trasete ekzistuese të linjave 110 kV, është ndërtimi i linjës së re 220 kV Burrel – Peshkopi dhe n/st 220/110 Peshkopi. Ky projekt parashikon ndërtimin e një linjë të re 220 kV Burrel – Peshkopi rreth 46 km dhe n/st 220/110 Peshkopi me fuqi 120 MVA, e cila përfaqëson e pare

(Lot I) konsiston në ndërtimin e linjës 220 kV rreth 46 km të gjatë dhe zgjerimin e nënstacionit 220 kV të Burrelit me një trakt linjë 220 kV të ri. Projekti përfundon plotësisht me implementimin e fazës së dytë (Lot II) që ka të bëjë me ndërtimin e nënstacionit të ri 220/110 kV të Peshkopisë me fuqi transformatorike 120 MVA dhe lidhjen me linjën 110 kV Lapaj-Peshkopi.

Ky projekt tepër i rëndësishëm do të garantojë operimin optimal të burimeve hidrike të zonës dhe një furnizim cilësor për konsumatorët. Ai ka një impakt të madh në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe përmirësimin e profilit të tensionit.

Në figurën e mëposhtme jepet diagrama njëfazore e rrjetit unazor 110 kV të zonës Verilindore:





➤ *Rehabilitimi i impianteve 110 kV të disa nënstacioneve 110/TM kV*

Rrjeti i transmetimit 110 kV ka një shtrirje të gjerë në të gjithë territorin e vendit. Në këtë rrjet janë lidhur rreth 75 nënstacione transformuese 110/TM kV, të cilët furnizojnë me energji elektrike të gjitha zonat urbane të vendit. Gjithashtu në zbarat e nënstacioneve 110 kV pranë zonave me burime hidrike janë lidhur një numër i rëndësishëm e HEC-eve të rinj. Pjesa më e madhe e rrjetit 110 kV dhe e nënstacioneve të lidhur në të, kanë tashmë një periudhë shfrytëzimi rreth 50 vjecare. Në këto nënstacione nuk janë bërë ndërhyrje rehabilituese dhe shkalla e amortizimit të pajisjeve të tyre është tepër e lartë.

- Sistemi i zbarave është me përcjellës me kapacitet të ulët dhe amortizimi i morsetave lidhëse është tepër i lartë.
- Pajisjet primare (cesa, thika) në disa nënstacione nuk komutohen dhe disa prej tyre janë të shuntuara apo mungojnë.
- Sistemi i mbrojtjes rele është me pajisje të vjetëruara që tashmë nuk përdoren më. Ai nuk është i sigurtë, nuk vepron në mënyrë selektive dhe në shumë raste nuk reagon fare.
- Sistemet e kontrollit lokal janë jashtë funksionit dhe manovrimet në disa raste behen vetëm në fushe, disa prej këtyre nënstacioneve nuk përfshihen në sistemin SCADA të qendres kombetare dispecer.
- Konstruksionet metalike të pajisjeve janë të koroduara, sistemi i tokezimit gjithashtu.

Si rezultat i kesaj gjëndjeje kemi pasoja në:

- Ndërprerje të furnizimit me energji të konsumatorëve apo të gjenerimeve të HEC-eve lokale, për shkak të dëmtimeve të shpeshta në rrjet dhe në pajisjet e nënstacioneve.
- Rrezikun me të cilin ndeshet personeli operativ gjatë manovrimit të rrjetit.
- Mungesa e elementeve komutues (çelesave në shumë prej këtyre nënstacioneve) ul shumë fleksibilitetin e skemes dhe shpesh behet shkak për ndërprerje të furnizimit të konsumatoreve për kryerjen e monovrimeve që janë të nevojshme për operimin në kohë reale.
- Veshtiresi në identifikimin e difekteve në linjat 110 kV për shkak të mungesës së selektivitetit dhe identifikimit të zonës ku është dëmtuar linja.

Nisur nga sa më sipër shohim të nevojshme për ndërhyrje rehabilituese (impiantin 110 kV) në disa nga nënstacionet e sistemit. Në përzgjedhjen e nënstacioneve është marrë në konsideratë:

- a) Shkalla e amortizimit të impianteve 110 kV.
- b) Rëndësia që kanë këto nënstacione për operimin në kohë reale dhe rritjen e fleksibilitetit të rrjetit 110 kV (nënstacione 110 kV që mbyllin unaza).



Konkretisht përveç çfarë ka qënë parashikuar më parë, do të kryhet ndërhyrje në këto nënstacione 110 kV:

1. *Rehabilitimi i trakteve të linjave 110 kV të nënstacionit Ibe.*
Me fond të parashikuar të investimit rreth 135,000,000 Lekë
2. *Rehabilitimi i trakteve të linjave 110 kV të nënstacionit Kajan.*
Me fond të parashikuar të investimit rreth 135,000,000 Lekë
3. *Rehabilitimi i trakteve të linjave 110 kV të nënstacionit Prrenjas.*
Me fond të parashikuar të investimit rreth 135,000,000 Lekë
4. *Rehabilitimi i trakteve të linjave 110 kV të nënstacionit Plasmas*
Me fond të parashikuar të investimit rreth 135,000,000 Lekë
5. *Rehabilitimi i trakteve të linjave 110 kV të nënstacionit F.Arrez*
Me fond të parashikuar të investimit rreth 170,000,000 Lekë

Duke pare gjendjen e nënstacioneve të mësipërm, rehabilitimi i tyre do të përfshijë:

- Demontimin e bazamenteve, portaleve, zbarave 110 kV, konstruksioneve metalike dhe pajisjeve primare e sekondare të zbarave dhe daljeve 110 kV të linjave.
- Instalimin e zbarave të reja 110 kV, ndarës seksionimi të zbarave dhe TT
- Instalimin e pajisjeve primare të daljeve komplete të linjave 110 kV të pajisura me sharkues, TT, ndarës, çelës, TR, sipas standartit të OST, në bazamente e konstruksione të reja.
- Sistem i ri i mbrojtjes rele dhe kontrollit me panele të reja në sallën e kontrollit, përfshirë zgjerimin në RTU ekzistues për dërgimin e të dhënave në QDS (SCADA).
- Sistem i ri i rrymës së vazhduar; grupi i baterive, radricatorët dhe ndricimit të avarisë.
- Rehabilitim i sistemi të tokëzimit të anës 110 kV dhe mbrojtjes nga goditjet atmosferike
- Punime civile që përfshijnë rehabilitimin e plotë të sheshit të nënstacionit, kanaleve të kablove, rrethimit, sallës së kontrollit, sistemin e drenazimit, etj.

Ndër projektet e tjera të rëndësishme janë:

- Punimet primare dhe sekondare në nënstacionin 220 kV Elbasan, demontimi i një çelësi ekzistues, furnizimi dhe vendosja e një çelësi të ri 245 kV me gas SF6, integrimi i plotë i tij me sistemin, si dhe furnizimi i pjesëve rezervë për çelësat aktual dhe pajisje elektrike suporti. Furnizim i mbrojtjes distancionale REL670, se bashku me panelet e tyre ose rele tjetër ekuivalent me të i cii realizon të njëjtat kerkesa.
- Ndërtimi i linjës 110 kV N/st Sallmone – Gjiri i Lalëzit.
- Rikonstruksioni i linjës 110 kV dyfishe Laç2-Ura e Matit dhe pjesa me një qark e linjës 110 kV Ura e Matit-Skuraj.



- Furnizim-Vendosje e një autotransformatori fuqie 120 MVA, 230/115/10.5 kV dhe i një sistemi total monitorimi të tij në Fierzë.
- Punime primare dhe sekondare në N/stacionin 220 kV Fierzë, instalimi i dy çelsave të rinj 245 kV me gaz SF6, integrimi i plotë me sistemin, si dhe furnizimi i pjesëve rezerve 220 kV.
- Furnizim vendosje e Shunt reaktorit 400 kV 120 MVA, Sistemit Total të monitorimit të tij, konfigurimin në sistemin SCADA, instalimin e traktit 400 kV në N/St Zemblak si dhe kryerja e të gjitha punimeve civile në lidhje me këtë projekt.
- Instalimi i Trosit me fibër Optike (OPGW) në linjën 220 kV Burrel – Elbasan1.
- Instalimi i një trakti linjë 110 kV Nënstacionin Lac1 dhe punime civile.

➤ Kostot kapitale është komponenti i të ardhurave të synuara për vitin bazë i cili synon të mbulojë pagesat që OST sh.a. duhet të kryejë për zhvillimin afatgjatë të rrjetit të transmetimit. Investimet përballohen kryesisht me fonde të huazuara nga institucione kreditimi nderkombetare (Banka Boterore, KfW etj) të cilat i japin OST sh.a. kredi me norma të buta për shkak të garancisë qeveritare për këto kredi. Pjesa e mbetur e investimeve përballohet me fondet e OST sh.a.

Me poshte gjeni edhe strukturen e Sistemit Shqiptar te Transmetimit te Energjise Elektrike/


Linjat e transmetimit

Linjat e interkonjeksionit

Nënstacionet

<ul style="list-style-type: none"> • 446 km 400 kV • 1250 km 220 kV • 34.4 km 150 kV • 1606.7 km 110 kV 	<ul style="list-style-type: none"> • 400 kV Tirana 2 – Podgorica (MN) • 400 kV Zemlak – Kardia (GR) • 400 kV Tirana 2 – Kosova B (KS) • 220 kV Fierza – Prizren (KS) • 220 kV Kopluk – Podgorica (MN) • 150 kV Bistrice – Myrtos (GR) 	<ul style="list-style-type: none"> • 1 Nst 400/220 kV, 600 MVA • 1 Nst 400/220/110 kV, 800 MVA • 1 Nst 400/110 kV, 300 MVA • 1 Nst 220/110/20 kV, 486 MVA • 9 Nst 220/110/TM kV, 1760 MVA • 1 Nst 150/110, 80 MVA
---	---	---

STRUKTURA E SISTEMIT TE SHQIPTAR TE TRANSMETIMIT



Kostot kapitale të OST sh.a. sipas metodologjisë për vitin 2018 duhet të mbulojnë:



- Detyrimet e vitit 2019 të principalit dhe interesit për fondet e huazuara sipas skeduleve të ripagesës së huave afatgjata.
- Investimet me fondet që OST sh.a. gjeneron nga aktiviteti të përfshira në Programin e Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2019.

$$C_{\text{kapital}} = R + D$$

R Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve
D Amortizimi i aseteve fikse dhe amortizimi i aseteve të tjera

$$R = B * WACC$$

B Aseti Bazë i Rregulluar në fillim të vitit bazë të ciklit të vlerësimit të tarifave
WACC Norma e lejueshme e kthimit të Asetit Bazë të Rregulluar.

Llogaritja e Asetit Bazë të Rregulluar (**B**) në fillim të vitit bazë 2019 (Vlera në fund të vitit 2018) është kryer duke llogaritur kapitalizimin e të gjitha investimeve në proces deri në 31.12.2018.

Në llogaritjen e amortizimit të vitit 2019, është mbajtur parasysh fakti që shtesat e vitit 2018 kontabilizohen përgjatë gjithë vitit dhe janë amortizuar për mesatarisht 6 muaj duke marrë në konsideratë kohën në të cilën kapitalizohen.

Për vitin 2019 amortizimi i parashikuar pritet të jetë rreth 2,451.9 milion lekë ndërsa Aseti Bazë i Rregulluar (RAB) në fillim të vitit 2019 është rreth 47,722 milion lekë.

Viti 2018						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e aseteve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e aseteve
1	2	3	4	5	6-3-5	
1	Software dhe licenca	205/208	618,798,794	100,249,368	257,577,665	361,221,128
2	Toka	211	2,296,608,723	4,046,007.71	12,307,923	2,284,300,800
3	Ndertesa	212	2,656,709,294	65,814,127.24	239,313,938	2,417,395,356
4	Instalime, makineri dhe Pajisje te tjera	213	48,562,015,377	1,970,906,290	7,137,908,554	41,424,106,823
5	Mjete transporti	215	556,428,791	35,991,016.73	142,859,345	413,569,446
6	Mobileri, pajisje zyre, pajisje informatike	218	1,252,601,832	174,952,614	430,953,562	821,648,270
Total			55,943,162,811	2,351,959,474	8,220,920,986	47,722,241,825

Viti 2019						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e aseteve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e aseteve
1	2	3	4	5	6-3-5	
1	Software dhe licenca	205/208	618,798,794	100,249,368	357,827,033	260,971,760
2	Toka	211	2,296,608,723	4,046,008	16,353,930	2,280,254,793
3	Ndertesa	212	2,656,709,294	65,814,127	305,128,065	2,351,581,229
4	Instalime, makineri dhe Pajisje te tjera	213	55,415,615,377	2,028,019,623	9,165,928,177	46,249,687,200
5	Mjete transporti	215	556,428,791	35,991,017	178,850,362	377,578,430
6	Mobileri, pajisje zyre, pajisje informatike	218	2,966,001,832	217,787,614	648,741,176	2,317,260,656
Total			64,510,162,811	2,451,907,757	10,672,828,743	53,837,334,068

Sipas metodologjisë norma e lejueshme e kthimit për Asetin Bazë të Rregulluar është:



Norma e lejuar e kthimit mbi Asetin Bazë të Rregulluar është mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit para taksave, e llogaritur si vijon:

$$WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)$$

$$ES + DS = 1$$

Ku:

ES	Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB
T	Norma e taksës së korporatës (Tatim-fitimi)
ARoE	Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse
DS	Objektivi për raportin e borxhit në RAB
CoD	Kosto e borxhit

ARoE - Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet të vendoset nga rregullatori mbi bazen e nevojës së OST-se për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale dhe shërbimin e borxhit duke gjykuar nga pasqyra e burimeve dhe përdorimit të fondeve në vitin bazë.

CoD - Kosto e borxhit – norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjatë është përcaktuar si shuma e pagesave të interesit mbi borxhin afatgjatë gjatë vitit baze, pjesëtuar me principalin total mbi borxhin afatgjatë (shuma totale e marrë borxh) në fillim të vitit bazë.

Struktura e kapitalit afatgjatë të OST sh.a. sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2017 është përbëhet nga kapitali i vet (58.4%) dhe borxhi afatgjatë në masën 41.6%.



Për vitin 2019 norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjatë është llogaritur: CoD=2.3% ndërsa pagesat që duhet të kryejë OST sh.a. gjatë vitit 2019 jepen më poshte:

Nr.	Kreditori	Valuta	2019					
			Disbursime		Principal		Interesa	
			Valute	Leke	Valute	Leke	Valute	Leke
1	World Bank (Nr.36710 ALB) (Gov.Al)	USD		-	158,148.76	17,019,969.17	38,559.96	4,149,822.90
2	World Bank (Nr.38720 ALB) (Gov.Al)	USD		-	33,523.38	3,607,786.16	11,579.80	1,246,218.08
3	E.B.R.D. (Nr.23830)	EUR		-	-	-	-	-
4	E.B.R.D. (Nr.33833)	EUR		-	32,539.25	4,094,739.58	441.54	55,563.39
5	E.B.R.D. (Nr.36112)	EUR		-	-	-	-	-
6	KfW - BISABU Project (Gov.Al) - Tranche I, II	EUR		-	35,772.14	4,501,566.10	7,646.30	962,210.39
7	European Investment Bank (Nr.21264)	EUR		-	1,296,676.34	163,173,750.63	298,558.00	37,570,538.72
8	EIB - Vlora Thermo Power Plant (Nr.22706)	EUR		-	44,896.06	5,649,720.19	11,337.50	1,426,711.00
9	JBIC (ABA P1) Rehabilitimi N/st. Fierze & V.Dejes	YEN		-	53,524,931.26	51,860,305.90	10,408,766.08	10,085,053.45
10	J.B.I.C-Japan (ABA-P2)	YEN		-	1,702,121.74	1,649,185.75	511,445.50	495,539.54
11	Comm.AID'98 (10 mld LIT)	EUR		-	83,855.14	10,552,330.82	10,481.90	1,319,042.30
12	Ristr.teknik & menaxhues - KESH. ITC 5	EUR		-	-	-	55,829.76	7,025,617.00
13	Swiss Grant (Gov.Al) SECO	CHF		-	930,000.00	102,467,400.00	-	-
14		USD		-	-	-	-	-
15	Exp.-Imp.Bank of Korea-No.ALB-I(Gov.Al)	EUR		-	854,501.70	107,530,493.93	404,776.30	50,937,049.59
16	KfW-400 kV- Tirane-Podgorice- I&II	EUR		-	2,695,464.62	339,197,267.78	38,530.12	4,848,630.30
17	WB-40870-USD	USD		-	1,484,932.82	159,808,470.09	447,730.54	48,184,760.71
18	Artigiancasa	EUR		-	-	-	1,018,932.83	128,222,507.33
19	KfW-Jug-10.750	EUR		-	-	-	80,625.00	10,145,850.00
20	KfW-Jug-37.750	EUR		-	4,441,176.00	558,877,587.84	1,158,258.83	145,755,291.32
21	KfW-Jug-0.5ml	EUR		-	-	-	10,000.00	1,258,400.00
22	KfW 400 kV Tirane-Prishtine	EUR		-	4,666,666.66	587,253,332.49	1,198,400.00	150,806,656.03
23	Efienca energjitike programi per sektorin e enegjise elek	EUR	15,778,064	1,985,511,510.84			275,708.00	34,695,094.72
24	1)Ndertimi i Linjes se Interkoneksionit 400 kV Elbasan- Bitola (Maqedoni); 2)N/Stacioni I Ri 400kV Elbasan 3; 3)Linja Elbasan Fier dhe 4) Nenstacioni Fier	EUR	9,256,312	1,164,814,302.08	2,630,000.00	330,959,200.00	171,875.00	21,628,750.00
25	Instalim Matjes/ Qendra e te dhenave	ALL	2,097,333,333	2,097,333,333.33			8,639,575.21	8,639,575.21
	Total			3,150,325,812.92		2,448,203,106.42		669,458,881.98



Pjesa e prapambetur e detyrimeve për kredi afatgjata është 6,256 milionë lekë dhe pritet që në 31.12.2018 të shkojë në vlerën 7,243 milionë lekë. Detyrimi për pagesën e këtyre kredive të prapambetura është e OSHEE sipas vendimit të ERE nr. 190, datë 22.12.2016.

Sipas metodologjisë:

- *Financimi afatgjatë i borxhit duhet përdorur për të financuar shpenzimet e reja kapitale për atë që është e mundur, por nuk duhet përdorur për të mbuluar kostot e operimit*

OST i përdor fondet e siguruar nga kreditë afatgjatë ekskluzivisht për investimet e reja kapitale. Gjatë viteve të fundit OST është angazhuar kredi afatgjata për të financuar projekte madhore për zgjerimin dhe përmirësimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Kjo gjë ka rritur detyrimet për interes dhe principal që duhen shlyer gjatë vitit 2019 të cilat, ashtu sic tregohen në tabelën e mësipërme, janë rreth 3,118 milion lekë.

B. Kostot operuese

$$C_{\text{operuese}} = C_{\text{matjes}} + C_{\text{mirëmbajtje}} + C_{\text{paga}} + C_{\text{humbjet}} + C_{\text{sherbimeve ndihmese}} + C_{\text{sherbime me të trete}} + C_{\text{takse}}$$

C_{matjes} kosto e matjes së energjisë elektrike dhe energjisë së livruar tek klientët e sistemit të transmetimit dhe kosto e faturimit dhe likuidimeve të llogarive me përdoruesit e sistemit të transmetimit

Këto kosto lidhen me kostot e shkaktuara nga klientët, por nuk përfshijn koston e matjes së humbjeve të energjisë elektrike, konsumin e energjisë elektrike për qëllime teknologjike dhe eksportin, importin dhe fluksin e tranzitit. Kostot e matjes janë të përfshira në kostot e tjera operuese të OST sh.a., respektivisht në kostot e pagave dhe mirëmbajtjes

C_{mirëmbajtje} pjesë zëvendësimi, furnizime, mjete, lëndë djegëse dhe kosto të tjera mirëmbajtje;
Në zbatim të ligjit 43/2015 për sektorin e energjisë elektrike, i cili shtyn kufirin e pronësive të OST sh.a dhe referuar miratimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë me shkres Nr: 12256/1 Prot dt.18/07/2018 është përfunduar transferimi i aseteve nga OSHEE në OST. Vlera e aseteve është 468,984,100 Lekë.

Shtyrja e kufirit të transmetimit, ose përshirja e trakteve të linjave dhe paisjeve të zbarave 110 kV në të gjitha nënstationet e OSHEE si asete të OST do të kërkojë një kosto operative shtese (shpenzime për mirëmbajtje) në raport me vitet e kaluara. Duke pasur parasysh që pjesa më e madhe e këtyre aseteve janë mbi 40 vjeçare dhe me një mase të konsiderueshme amortizimi, mendojmë që të



parashikohet një shtesë në masën 50% të shpenzimeve për mirëmbajtje krahasuar me vitin 2018.

- C paga** pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe kostot (Të ndryshme nga taksat) të lidhura me programet në përfitim të të punësuarve;
- C humbjet** kostot për mbulimin dhe prokurimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit

Në llogaritjen e tarifës së transmetimit, kosto për humbjet janë llogaritur duke u bazuar në çmimet e tregut:

$$C_{\text{humbje}} = E_{\text{humbje}} * P_h$$

- E humbje** humbjet e energjisë në rrjetin e transmetimit gjatë vitit bazë
- Ph** çmimi mesatar i energjisë elektrike që do të blihet në treg për mbulimin e humbjeve gjatë vitit bazë.
- C shërb. Ndhimëse** pagesa për blerjen e shërbimeve ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit.

Në mënyrë të detajuar, kostot e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse jepen në kapitullin V. Në shërbimet ndihmëse përfshihen pagesat që OST sh.a. kryen kundrejt OST-ve të tjera për "PAN-EUROPEAN INTER-TSO COMPENSATION MECHANISM". Ky mekanizëm është projektuar për të kompensuar palët për shpenzimet që lidhen me humbjet që rezultojnë nga mbartja e flukseve të energjisë në sistemet e tyre. Rritja e çmimit me të cilin OST sh.a. blen energjinë për mbulimin e humbjeve ka sjellë automatikisht edhe rritjen e pagesave që OST sh.a. do të kryejë kundrejt OST-ve të tjera për mekanizmin ITC duke qënë se formula e llogaritjes së kompensimeve të ndërsjellta përfshin çmimin e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit.

- C takse** Komponenti që mundëson që rregullatori të tregojë qartë pjesën e tarifës që atribuohet taksave dhe prandaj është përtej kontrollit të rregullatorit. Komponenti takse të ardhurave të synuara të OST-se për vitin baze, nuk përfshin TVSH-ne dhe tatimin mbi fitimin.



C. Të ardhurat nga Alokimi i Kapaciteteve

Në mbështetje të hapjes dhe zhvillimit të tregut të kapaciteteve në interkoneksion, janë miratuar “Rregulla për Alokimin e Kapaciteteve në Interkoneksione”, në Nëntor të vitit 2013 si dhe rregullat për alokimin e kapaciteteve në Zyrën Rajonale të Alokimit të Kapaciteteve, “SEE CAO” e cila edhe për 2019 do të alokojë kapacitetet e dy nga tre kufijve të interkoneksionit.

Nëse do të realizohet njohja e Kosovës si Bllok me vete nga ana e ENTSO-e edhe kufiri AL-KS do të alokohet në SEE CAO.

Duke konsideruar se volumi i transaksioneve të energjisë, pra edhe i kërkesës për kapacitete transmetuese në interkoneksion, nuk është proporcional përgjatë gjithë muajve të vitit si dhe duke konsideruar risitë dhe paqartësitë e alokimit të kapaciteteve në interkoneksione nga zyra përkatëse rajonale, CAO në Podgorice parashikimi i të ardhurave që OST mund të sigurojë në anketat e alokimit të kapacitetit në interkoneksion përgjatë gjithë vitit 2019 parashikohet të jetë rreth 9 milion Euro.

VIII. Ndarja e kostove në kapacitet dhe energji

i. Pagesat e kapacitetit

Përdoruesit e energjisë elektrike paraqesin një ngarkesë elektrike që ndryshon në çdo cast. Rrjeti elektrik duhet të ndërtohet i tillë që të garantojë shërbimin e energjisë elektrike brenda parametrave teknike dhe të sigurisë në çdo moment të kohës. Llogaritjet për fuqizimin e rrjetit elektrik bëhen për rastin më të rëndë që është ngarkesa e pikut, pra ato varen nga ngarkesa maksimale e konsumatorëve gjatë periudhës llogaritëse dhe jo nga energjia elektrike që ata konsumojnë gjatë kësaj periudhe.

Për këtë, investimet që bëhen për fuqizimin e kapacitetit transmetues të rrjetit elektrik janë funksion i ngarkesës maksimale që paraqesin përdoruesit e këtij rrjeti.

Cdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë kapaciteti në lekë/kW/Muaj, të bazuar në ngarkesën pik gjatë periudhës 12 mujore që mbaron në muajin e faturimit.

Të ardhurat totale të mbledhura nëpërmjet pagesave të kapacitetit për vitin 2019 janë të barabarta me:

$$C \text{ kapacitet} = C \text{ kapital}$$

$$C \text{ kapacitet} = C \text{ kapital} - R \text{ Alokimi}$$

$R \text{ Alokimi}$ Janë të ardhurat nga alokimi i kapaciteteve nderkufitare të cilat për efekt të llogaritjes së Tarifave të Transmetimit nuk përfshihen në totalin e të ardhurave të kërkuara.

Gjatë 3 viteve të fundit, shuma e kapacitetit total mujor të bazuar në ngarkesën pikë gjatë periudhës 12 mujore për secilin klient të lidhur në rrjetin e transmetimit ka qënë si më poshtë:



Viti 2016				
Nr.	Subjekti	Ora	Data	Kapaciteti (kW)
1	DEVOLLIHPP-T1/751	11:00	17-11-16	2,260
2	EL220-L220KURUM/659	3:00	14-12-16	54,257
3	F.Arrez-T3/653	11:00	06-04-16	205
4	FERRO KROM-F2(10kV)/228	13:00	07-03-16	258
5	FERRO KROM-F4(10kV)/229	7:00	19-08-16	158
6	FUSHE KRUIJE 220kV-T2/058	16:00	05-02-16	22,866
7	HEC ASHTA1-T1/035	23:00	07-11-16	122
8	HEC ASHTA2-T1/213	17:00	08-11-16	102
9	N/ST 220/6,3COLACENT-T1/043	10:00	24-03-16	6,431
10	N/ST i GSA EL 110kV -T1/057	21:00	06-03-16	18,514
11	TEC Ballsh-T1/598	18:00	23-12-16	8,307
12	TITAN 220kV-T1/126	5:00	07-01-16	9,563
13	TITAN 220kV-T2/127	1:00	11-01-16	9,779
SHUMA E KONSUMATOREVE TE TJERE				132,822
14	OSHEE	18:00	31-12-16	1,479,075
SHUMA E SISTEMIT				1,611,897
Viti 2017				
Nr.	Subjekti	Ora	Data	Kapaciteti (kW)
1	DEVOLLIHPP-T1/751	22:00	28/11/2017	2,675
2	EL220-L220KURUM/338	23:00	06-07-17	55,748
3	F.Arrez-T3/653	19:00	28/09/2017	2,184
4	FERRO KROM-F2(10kV)/228	16:00	20/12/2017	7,619
5	FERRO KROM-F4(10kV)/229	4:00	23/08/2017	10,038
6	FUSHE KRUIJE 220kV-T2/058	9:00	26/10/2017	22,948
7	HEC Ashta1-T1/035	3:00	16/08/2017	126
8	HEC ASHTA2-T1/213	22:00	16/08/2017	143
9	HEC Banje-T1/753	21:00	17/08/2017	233
10	HEC Banje-T2/755	15:00	18/08/2017	152
11	HEC Fang-T1/544	22:00	12-06-17	141
12	HEC Fang-T2/757	5:00	29/11/2017	139
13	HEC Peshqesh-T1/633	3:00	27/12/2017	156
14	N/ST 220/6,3COLACENT-T1/043	21:00	22/05/2017	5,975
15	N/ST i GSA EL 110kV-T1/694	5:00	11-02-17	22,460
16	N/ST i GSA EL 110kV-T2/960	18:00	09-06-17	11,425
17	TEC Ballsh-T1/598	20:00	04-05-17	8,994
18	TITAN 220kV-T1/126	15:00	15/06/2017	9,774
19	TITAN 220kV-T2/127	8:00	15/06/2017	10,123
SHUMA E KONSUMATOREVE TE TJERE				171,054
20	OSHEE	19:00	12-01-17	1,342,680
SHUMA E SISTEMIT				1,513,734



Viti 2018				
Nr.	Subjekti	Ora	Data	Kapaciteti (kW)
1	DEVOLLIHPP-T1/751	16:00	01-04-18	2,662
2	EL220-L220KURUM/338	21:00	03-03-18	54,944
3	F.Arrez-T3/653	18:00	23/05/2018	2,015
4	FERRO KROM-F1(10kV)/342	8:00	20/01/2018	7,168
5	FERRO KROM-F2(10kV)/228	10:00	29/03/2018	7,259
6	FERRO KROM-F3(10kV)/343	19:00	17/4/2018	11,043
7	FERRO KROM-F4(10kV)/229	7:00	01-01-18	10,197
8	FUSHE KRUJE 220kV-T2/058	10:00	23/04/2018	22,433
9	HEC Ashta1-T1/035	4:00	20/03/2018	114
10	HEC ASHTA2-T1/213	2:00	06-04-18	114
11	HEC Banje-T1/753	15:00	06-12-18	169
12	HEC Banje-T2/755	4:00	26/06/2018	168
13	HEC Fang-T1/544	21:00	23/03/2018	146
14	HEC Fang-T2/757	6:00	24/05/2018	84
15	HEC Peshqesh-T1/633	2:00	14/01/2018	155
16	N/ST 220/6,3COLACENT-T1/043	15:00	18/07/2018	5,848
17	N/ST i AES EL 110kV-T1/690	13:00	03-06-18	19,583
18	N/ST I AES EL 110kV-T2/692	15:00	03-06-18	19,990
19	N/ST i GSA EL 110kV-T1/694	12:00	23/1/2018	22,241
20	N/ST i GSA EL 110kV-T2/960	15:00	06-08-18	11,824
21	TEC Ballsh-T1/598	15:00	07-06-18	8,745
22	TITAN 220kV-T1/126	23:00	02-06-18	9,534
23	TITAN 220kV-T2/127	3:00	07-02-18	9,887
SHUMA E KONSUMATOREVE TE TJERE				226,323
15	OSHEE	19:00	28/02/2018	1,245,020
SHUMA E SISTEMIT				1,471,343

Duke analizuar situatën elektroenergjitike për vitin 2019, OST sh.a. vlerëson se shuma e kapaciteteve totale të Konsumatoreve të Kualifikuar + OSHEE do të jetë e barabartë me 1,450,000 kW.

Pagesa e kapacitetit në lekë për kW në muaj është e barabartë me:

$$P_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapacitet}} \div L$$



L - shuma e kapacitetit total mujor e treguar në faturat e transmetimit, gjatë 12 muajve të vitit baze

ii. Pagesat e energjisë

Çdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë për energjinë në lekë/kWh, bazuar në sasinë e kWh të livruar nga sistemi i transmetimit tek klienti i sistemit të transmetimit gjatë atij muaji.

Të ardhurat totale të mbledhura nëpërmjet pagesave të energjisë në vitin bazë janë të barabarta me:

$$C_{\text{energji}} = C_{\text{matjes}} + C_{\text{mirëmbajtje}} + C_{\text{paga}} + C_{\text{humbje}} + C_{\text{tek}} + C_{\text{jashteburimore}} + C_{\text{taksa}}$$

Pagesa e energjisë në lekë për kWh është e barabartë me:

$$P_{\text{energji}} = C_{\text{energji}} / E$$

E - energjia totale në kWh që do tregohet në faturat e klientit të sistemit të transmetimit gjatë vitit baze

Pagesat e energjisë përfshijnë edhe kostot e nevojshme për matjen, faturimin dhe kostot e likuidimit të OST-se për të siguruar shërbimin e matjes së energjisë për klientët e lidhur në rrjetin e transmetimit. Në këtë mënyrë, OST sh.a. nuk ka kërkuar një tarifë të vecante për matjen e energjisë ashtu sic parashikohet në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit ku secili prej klientëve të sistemit të transmetimit duhet të paguajë: **Pagesa mujore fikse në lekë për pikë livrimi është e barabartë me: $P_{\text{mujore}} = C_{\text{matjes}} / N$**

iii. Llogaritja e tarifës mesatare të transmetimit

Në çdo vit të ciklit të shqyrtimit të tarifës, tarifa mesatare e transmetimit është e barabartë me:

$$P_{\text{mesatare}} = (C_{\text{kapacitetit}} + C_{\text{energjisë}}) / E$$

P mesatare - tarifa mesatare e transmetimit

OST ka parashikuar treguesit për vitin 2019 sipas 3 skenarëve të mundshëm, të cilët varen nga niveli i tarifës së transmetimit të energjisë elektrike që ERE do të caktojë.

Metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit		Viti 2019		
Pershkrimi	Njesia	Version 1	Version 2	Version 3
Niveli I synuar I të ardhurave (I+II+III)	Milion Leke			
$C = C_{\text{kapital}} + C_{\text{operuese}}$ - Te ardhurat nga abkimi i kapaciteteve		9,052	6,835	6,035
I. $C_{\text{kapital}} = R + D$		6,069	2,952	2,952
1 Kthimi mbi kapitalin ($R = B \cdot wacc$)	Milion Leke	3,617	500	500
a. B (Baza e rregulluar e asetëve)	***	47,722	47,722	47,722
b. $WACC = [ES \cdot ARoE / (1-T)] + (DS \cdot CoD)$	%	7.58%	1.05%	1.05%
ES - Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB	***	58.4%	58.4%	58.4%
T - Norma e takses së korporatës	***	15%	15%	15%
ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	***	9.6%	1.5%	1.5%
DS - Objektivi për raportin e borxhit në RAB	***	41.6%	41.6%	41.6%
CoD - Kosto e borxhit	***	2.3%	0.0%	0.0%
2 Amortizimi i vitit (D)	Milion Leke	2,452	2,452	2,452
II. C_{operuese}	***	5,083	5,083	4,283
1 Personeli	***	1,380	1,380	1,380
2 Shërbime administrative e të tjera	***	620	620	620
3 Materiale të para	***	130	130	130
4 Blerja e shërbimeve ndihmëse	***	1,000	1,000	200
5 Blerja e humbjeve	***	1,400	1,400	1,400
6 Pagesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	***	500	500	500
7 Pagesë për organizmat rajonale e europiane	***	50	50	50
8 Taksa	***	3	3	3
III. Te ardhurat nga alokimi i kapaciteteve	***	(1,200)	(1,200)	(1,200)
E - Energjia e transmetuar (OSHEE + të tjere)	GWh	7,158	7,158	7,158
Tarifa mesatare e transmetimit	Lek/kWh	1.39	0.95	0.84
1 $P_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapital}} / L$	Leke/kW/muaj	279.8	100.7	100.7
$C_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapital}} - \text{Te ardhurat nga Alokimi}$	Milion leke	4,869	1,752	1,752
L - shuma e kapacitetit total mujor	kW	1,450,000	1,450,000	1,450,000
2 $P_{\text{operuese}} = C_{\text{operuese}} / E$	Leke/kWh	0.71	0.71	0.60
C operuese	Milion leke	5,083	5,083	4,283
E - Energjia e transmetuar (OSHEE + të tjere)	GWh	7,158	7,158	7,158
3 $P_{\text{mesatare}} (\text{Tarifa mesatare e transmetimit}) = (C_{\text{kapacitet}} + C_{\text{operuese}}) / E$	Lek/kWh	1.39	0.95	0.84

I. Versioni 1

Ky version parashikon përbushjen e të gjitha detyrimeve të OST sh.a. përgjatë vitit 2019, duke përfshirë pagesën e detyrimeve për kredi të cilat aktualisht janë detyrim i OSHEE për t'u paguar, referuar vendimeve të ERE nr. 52, date 6.4.2017 dhe nr.190, datë 22.12.2016 të cilët përcaktojnë se:



“OSHEE sh.a, përveç shlyerjes së detyrimeve korente, të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a dhe OST sh.a nga detyrimet e prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a dhe KESH sh.a.”;

Ju bëjmë me dije se për vitin 2019 OST duhet të paguajë rreth 3,118 milion lekë në bazë të marrëveshjeve për ripagimin e kredive me Ministrinë e Financave dhe KESH. Vetëm shtesa e detyrimit për të paguar kreditë, shërbimet ndihmëse dhe ITC nga ana e OST do të kërkonte që tarifa të rritej me 0.64 Lekë/KWh.

II. Versioni 2

Sipas versionit 2, OST vazhdon të mos paguajë kreditë por ndryshimi në krahasim me situatën aktuale është blerja në treg të shërbimeve ndihmëse me një vlerë prej rreth 1,000 milion lekësh në vit ndërkohë që vlera me të cilën aktualisht po i siguron ato është rreth 200 milion lekë. Shtesa në tarifë për këtë rast rezulton 0.2 Lekë/KWh.

III. Versioni 3

Versioni i 3-të është pothuajse i ngjashëm me situatën aktuale të OST, pra shërbimet ndihmëse sigurohen nga KESH si dhe kreditë nuk paguhen referuar vendimeve të ERE nr. 52, datë 6.4.2017 dhe nr.190, datë 22.12.2016. Shtesa prej një 0.09 Lekë/KWh rezulton kryesisht si efekt i rritjes së shpenzimeve për ITC ndryshimeve në zëra të tjerë të shpenzimeve të tjera.

Në vijim po ju paraqesim një pasqyrë me detyrimet e prapambetura të krijuara në vite, që mendojmë se duhen marrë në konsideratë nga ana e ERE në shqyrtimin e aplikimit për tarifën e transmetimit.



Detyrimet OST ndaj MFE deri me 17.09.2018

Detyrimi	Emertimi i Llogarise	Leke		Leke	
		31 Dhjetor 2017		Gjendje 17.09.2018	
		MFE ndaj OST	OST ndaj MFE	MFE ndaj OST	OST ndaj MFE
OST - MFE	OST detyrimet per principalet e kredive		1,872,764,184		2,458,931,800
OST - MFE	OST detyrimet per interesat e kredive		628,129,104		889,457,652
OST - MFE	OST detyrimet per Tarifat e kredive (comm. Fee)		2,288,423		-
OST - MFE	OST detyrim per dividendin		811,034,209		931,865,897
	Totali		3,314,215,920		4,280,255,349
	Gjendja Neto		3,314,215,920		4,280,255,349

Detyrimet e ndersjellta KESH - OST deri me 17.09.2018 - Tregtare

Detyrimi	Emertimi i Llogarise	Leke		Leke	
		31 Dhjetor 2017		Gjendje 17.09.2018	
		KESH ndaj OST	OST ndaj KESH	KESH ndaj OST	OST ndaj KESH
KESH - OST	OST(Blerje Energjie per disbalancat)			419,223,592	
KESH - OST	OST(Transmetim energjie)			4,478,240	
KESH - OST	Detyrime per transferimin e aseteteve te nenstacioneve	73,069,514		73,069,514	
OST - KESH	OST (Shitje Energjie per disbalancat)		766,589,478		3,094,419,858
OST - KESH	OST sha (Energjia e humbjeve)		217,991,343		328,647,847
OST - KESH	OST sha (Sherbime ndihmese)		9,476,208		101,137,884
OST - KESH	OST detyrim kosto lokale per transferim asetesh		9,400,520		9,400,520
	Totali	73,069,514	1,003,457,549	496,771,346	3,533,606,109
	Gjendja Neto		930,388,035		3,036,834,763

Detyrimet e ndersjellta KESH - OST deri me 17.09.2018 - Kredi

Detyrimi	Emertimi i Llogarise	Leke		Leke	
		31 Dhjetor 2017		Gjendje 17.09.2018	
		KESH ndaj OST	OST ndaj KESH	KESH ndaj OST	OST ndaj KESH
OST - KESH	OST detyrimet per principalet e kredive		1,895,562,725		2,604,782,516
OST - KESH	OST detyrimet per interesat e kredive		245,265,144		303,113,524
	Totali	-	2,140,827,869	-	2,907,896,041

Detyrimet e ndersjellta OSHEE - OST deri me 17.09.2018

Detyrimi	Emertimi i Llogarise	Leke		Leke	
		31 Dhjetor 2017		Gjendje 17.09.2018	
		OSHEE ndaj OST	OST ndaj OSHEE	OSHEE ndaj OST	OST ndaj OSHEE
OSHEE-OST	Transmetim energjie	8,541,847,163		8,955,286,713	
OSHEE-OST	Disbalanca	557,930,643		3,439,737,446	
OSHEE-OST	Disbalanca energjie Prill 2012	24,518,730		24,518,730	
OSHEE-OST	Kolaudim mates	12,000		12,000	
OSHEE-OST	Pagese pune oer sherbimet e DTL Tirane	3,144,361		3,144,361	
OSHEE-OST	Matesa elektrike me NJOF	1,162,721		1,162,721	
OSHEE-OST	Automjete te vena ne dispozicion nga NJMT	2,932,519		2,932,519	
OSHEE-OST	Penalitet per faturen Nr. 497 date 31.12.2015	490,054		490,054	
OST-OSHEE	Disbalanca				286,423,001
	Totali	9,132,038,191	-	12,427,284,544	286,423,001
	Gjendja Neto		(9,132,038,191)		(12,140,861,543)

Detyrimet e OST ndaj MFE dhe KESH për pagesat e borxhit afatgjatë janë në vlerën 3,348 milion Lekë dhe 2,907 milion Lekë respektivisht. Ndërkohë që detyrimi ndaj KESH për marrëdhëniet tregtare është në vlerën 3,036 milion Lekë.

Nga ana tjetër detyrimet e OSHEE ndaj OST janë në vlerën 12,140 milion Lekë dhe aktualisht paguhet nga OSHEE vetëm tarifa e transmetimit. Pagesat që OSHEE duhet të kryejë për shlyerjen e borxhit afatgjatë sipas vendimeve të ERE nr. 52, date 6.4.2017 dhe nr.190, datë 22.12.2016 nuk janë kryer gjatë vitit 2018.



E drejta për të arkëtuar neto e OST për detyrimet e lartpërmendura është në vlerën 1,916 milion Lekë. Mospagesa e kësteve të kredive nga OST po e rëndon gjëndjen financiare të kompanisë si pasojë e rritjes së kostos së borxhit që është një tregues kryesor në llogaritjet e tarifës së transmetimit. Ju lutemi të merrni në konsideratë të dhënat e mësipërme në mënyrë që OST, duke filluar nga viti 2019, të ketë mundësi të fillojë të shlyejë detyrimet e prapambetura si dhe detyrimet e saj korrente.

Mbi metodologjinë e llogaritjes së tarifës së energjisë elektrike të transmetuar.

Metodologjia e llogaritjes së tarifës së transmetimit, bazohet vetëm në energjinë elektrike të transmetuar tek konsumatorët e brendshëm.

Kjo metodologji është bazuar në vlerësimet retrospektive të energjisë për nevojat e vendit dhe planifikimin afatshkurtër në vijim, duke vlerësuar dhe humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit. Këto të fundit gjithashtu janë planifikuar në bazë të të dhënave retrospektive, ndërkohë që janë shumë të ndjeshme kundrejt raportit prodhim vendi/import.

Në kushtet e një importi të lartë për mbulimin e nevojave të vendit, fluksi i energjisë elektrike vjen nëpërmjet rrjetit 400 kV direkt e në qendrat më të mëdha të konsumit Tiranë dhe Elbasan, ndërkohë që rrjeti 220 kV dhe 110 kV është fare pak i ngarkuar, pasi centralet e lidhura në të punojnë me gjenerim të ulët. Rrjedhimisht në këtë regjim pune dhe humbjet e përgjithshme në rrjetin e transmetimit janë të ulta.

Në kushtet të favorshme hidrologjike kur një pjesë e gjenerimit të brendshëm eksportohet, kemi ngarkim të lartë të rrjetit 220 kV dhe 110 kV dhe respektivisht humbje të mëdha të energjisë elektrike në këto rrjeta. Në këtë rast energjia e transmetuar është shumë e lartë, por pjesa që shkon në eksport nuk ndikon në tarifë, ndonëse kjo mund të përbëjë deri në 50% të energjisë së transmetuar.

Futja në operim e burimeve të reja të rinovueshme vitet e fundit dhe e të tjerëve që janë në proces, do të ndryshojë ndjeshëm raportin prodhim vendi/import në favor të rritjes së importit.

Nëse do të referohemi shifrave të tremujorit të parë të vitit 2018, realizimi i humbjeve në transmetim ishte 87 milion KWh kundrejt një planifikimi prej 45 milion KWh. Vetëm për muajin Mars humbjet e energjisë elektrike rezultuan 37 milion KWh, kundrejt planifikimit prej 15 milion kWh. të njëjtat shifra rezultuan edhe për muajin Prill. Kjo situatë e ka vënë OST në një pozitë tepër të vështirë financiare.

Vende të caktuara bëjnë një ndarje në përqindje të tarifës së transmetimit ndërmjet gjeneruesve dhe konsumatorëve. Vënde të tilla si Austria, Mali i Zi, Norvegjia, Suedia, e mbulojnë tarifën e transmetimit në masën 35-38% nga gjeneruesit dhe 65-68% nga konsumatorët.

Për të ulur efektin financiar të raportit prodhim/eksport në mbulimin e humbjeve të transmetimit, një metodologji e tillë do të ishte e përshtatshme dhe për OST, e cila në kushte të transmetimit të një sasive energjie të lartë (por dhe me humbje të larta) do të kompensohej nga të ardhura të përgjithshme me të larta dhe në kushte të transmetimit të një sasive energjie të pakët (dhe me humbje të ulta) do të përfitonte të ardhura të përgjithshme më të ulta.



Energjia e eksportuar është energji e transmetuar që ngarkon rrjetin, shkakton humbje dhe kërkon kryerjen e investimeve për ta mundësuar atë. Të gjitha investimet e planifikuara për periudhat e ardhshme janë të domosdoshme kryesisht për situatën me eksport të lartë dhe jo për të furnizuar ngarkesën (konsumatorët).

Një mënyrë tjetër për kompensimin e OST në situata të tilla do të ishte ngarkimi me një tarifë të caktuar gjeneruesve që e çojnë energjinë për eksport.

Për sa më sipër do të propozonim që tarifa e transmetimit të ndahet duke i ngarkuar rreth 1/3 e saj gjeneruesve dhe rreth 2/3 e saj konsumatorëve. Kjo do të sillte një tarifë rreth 2 Euro/MWh për tu paguar nga gjeneruesit. Kjo lloj metodologjie do të shpërndante edhe varësinë financiare të OST në një bazë më të gjërë klientësh. Saktësimi i saj do të kërkonte një analizë më të hollësishme financiare për përcaktimin e saktë të metodologjisë.

OST kërkon nga ERE fillimin e procedurave për shqyrtimin e ndryshimit të metodologjisë së llogaritjes së tarifës së energjisë elektrike të transmetuar për ta përshtatur atë me tipologjinë e rrjetit të transmetimit shqiptar.

OST mbetet në dispozicionin Tuaj për çdo informacion shtesë që mund të kërkohej nga ana Juaj në funksion të përcaktimit të tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019.

Ju faleminderit,

**Administratori i OST sh.a.
Klodian Gradeci**

